



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIMI

Nr 104 datë 29.12.2022

PËR

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT
“SUBVENCIONI QIRASË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, pikës 18 të VKM nr. 384 datë 12.06.2019, “Për caktimin e dokumentacionit për të përfutur sipas programit social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 361 datë 29.05.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”, vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “ Subvencionit i Qirasë”, sipas Udhëzuesit Operacional, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- 2- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I KËSHILLIT

LAVDI HASANI

